REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr. Prot **Bilisht më, . .2026**

PROJEKT – VENDIM
NR. 54 , Date, 24 .06 .2026

"PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË BARAZISË GJINORE BASHKIA DEVOLL 2026–2028"

Në mbështetje të nenit 24 dhe 54 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, nenin 36 të Ligjit Nr. 121/2016 "Për shërbimet të kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", I ndyshuar, Ligjit 22/2018 "Për strehimin social", ligjit Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojten e Fëmijëve", Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverjes vendore", i ndryshuar, Ligji Nr.64/2025 "Për barazinë gjinore", Ligji Nr. 11/2026, "Për parandalimin dhe mbrotjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje", Ligji Nr.10221/04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, VKM-së Nr. 224 datë 09.04.2024 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimet të kujdesit shoqëror".

PROPOZOJ:

1. Miratimin e Planit Vendor të Barazisë Gjinore për Bashkinë Devoll 2026-2028 sipas tekstit bashkëngjitur këtij projektvendimi.
2. Shfuqezimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr 28. datë 27.02.2026
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore dhe Sektori i Planifikimit të Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar.

Konceptoi: Përgj. i sektorit të Kujdesit Social dhe PAK
Marilda Bejleri
Miratoi: Drejtori i Shërbimeve Sociale
Zerina Sinani
Konfirmoi bazën ligjore: Përgj. i sektorit Juridik dhe i prokurimeve
Eriksela Avdo
Konfirmoi: Sekretar i Përgjithshëm
Adriana Rushitaj

KRYETARI I BASHKISË
EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

Nr. 2446 **Prot** **Bilisht më,** 24.04.**2026**

RELACION
Për projekt-vendimin
"PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË BARAZISË GJINORE BASHKIA DEVOLL 2026–2028"

II.Shpjegime dhe informacione të posacme rreth aktit administrativ normativ **"Mbi miratimin e Planit Vendor për Barazinë Gjinore të Bashkisë Devoll për vitin 2026-2028"**

Në mbështetje të nenit 24 dhe 54 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, nenin 36 të Ligjit Nr. 121/2016 "Për shërbimet të kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", ligjit 22/2018 "Për strehimin social", ligjit Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojten e Fëmijëve", ligji Nr. 86/2017 "Për financat e vetëqeverjes vendore", Ligji Nr.9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri", Ligji Nr. 11/2026, "Për përandalimin dhe mbrotjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje", Ligji Nr.221/04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, VKM-së Nr. 150 datë 20.03.2019 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimet të kujdesit social".
Qëllimi i këtij Plani është të promovojë barazinë gjinore dhe të garantojë përfshirje të barabartë të grave dhe burrave në të gjitha fushat e jetës publike dhe ekonomike në Bashkinë Devoll, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror", si dhe me praktikat e buxhetimit të ndjeshëm ndaj gjinisë. Parimet udhëheqëse janë: mosdiskriminimi, gjithëpërfshirja, transparenca, përgjegjshmëria, partneriteti dhe prova statistikore.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2026–2028 është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 28, datë 27.02.2026. Megjithatë, ky plan nuk ka marrë ende konfirmimin e Prefektit të Qarkut Korçë.Për këtë arsye, propozohet rishqyrtimi dhe konfirmimi i Planit Vendor të Barazisë Gjinore 2026–2028 nga Këshilli Bashkiak i Bashkisë Devoll, me qëllim vijimin e procedurës për miratimin përfundimtar nga Prefektura e Qarkut Korçë.

Gjithashtu, propozohet: **Shfuqezimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 28, datë 27.02.2026, "Për miratimin e Planit Vendor të Barazisë Gjinore të Bashkisë Devoll 2026–2028", dhe miratimi i një vendimi të ri për të njëjtin objekt, në përputhje me procedurat ligjore në fuqi.**

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2026 - 2028 si një instrument për institucionin e Bashkisë Devoll, mbështetet në një tërësi dokumentesh të rëndësishëm ligjorë dhe institucionalë, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe përparimin drejt barazisë gjinore në Shqipëri.
Në përputhje me pikat 2 dhe 3 të nenit 36 të Ligjit 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror pranë bashkive ngrihen struktura të posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe pranë çdo njësie administrative, në varësi të bashkisë, ngrihet njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit. Në çdo njësi administrative në varësi të bashkisë, me përjashtim të bashkive me më pak së 6 mijë banorë, ngrihet Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit e cila, në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, janë këto rezultate të pritshme:

- Veprimet e Bashkisë Devoll për të nxitur rritjen e punësimit dhe fuqizimin ekonomik të grave e të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përmirësuara ndjeshëm.
- Masat që synojnë nxitjen e sipërmarrjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përshtatura me nevojat e tyre specifike.
- Rritja e pjesëmarrjes ekonomike dhe sociale të grave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, me fokus gratë dhe vajzat nga zonat rurale, të rinjtë dhe gratë kryefamiljare
- Mbështetja e grave sipërmarrëse dhe atyre të angazhuara në bujqësi, turizëm rural dhe zanate tradicionale
- Përmirësimi i aksesit të grave dhe vajzave në arsimin profesional, teknologji dhe tregun e punës.

Treguesit në nivel objektivi specifik:

- Numri i grave dhe të rejave përfituese nga aktivitetet e fuqizimit të kapaciteteve (trajnime dhe programe të formimit profesional), ndarë sipas moshës, përkatësisë etnike-kulturore, aftësisë së kufizuar, vendbanimit, llojit të aftësive të përfituara (llojit të trajnimit)
- Numri i sipërmarrjeve të reja, të themeluara ose të drejtuara nga gratë dhe të rejat, të cilat kanë marrë mbështetje financiare nga bashkia dhe/ose burime të tjera financimi (donatorë të huaj) gjatë periudhës së zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ), e ndarë sipas sektorëve (biznes, bujqësi, turizëm, teknologji, etj.).

Hartimi i Planit Vendor të Barazisë Gjinore të Bashkisë Devoll udhëhiqet nga parimet që vijojnë:

- ✓ Respektimi dhe garantimi i të drejtave për mbrojtje dhe siguri sociale në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare dhe legjislacioni kombëtar;
- ✓ Nxitja e pjesëmarrjes të grupeve përfituese dhe grupeve të tjera të interesit, përgjatë procesit të hartimit të planit si edhe të monitorimit të zbatimit të tij ;
- ✓ Fuqizimi në nivel personal dhe komunitar i individëve në nevojë, duke realizuar integrimin dhe përfshirjen e tyre në aktivitete ekonomike e sociale;
- ✓ Zbatimi i politikave lokale të mbështetura në parimet e mbrojtjes të interesit më të mirë të fëmijës dhe të respektimit të barazisë gjinore ;
- ✓ Ndërtimi i politikave lokale në përputhje me kompetencat vendore që rrjedhin nga Ligji mbi Reformën Territoriale.
- ✓ Garantimi i aksesit të barabartë tek shërbimet e decentralizuara të shërbimeve shoqërore;
- ✓ Ofrimi i shërbimeve shoqërore të ndërtuara mbi parimin e de-institucionalizimit;

✓ Ndërtimi i shërbimeve të qëndrueshme nga pikëpamja financiare dhe kosto-efektive.

Fusha e Ndërhyrjes 1: PROMOVIMI I TË DREJTAVE EKONOMIKE, SOCIALE DHE TË PUNËSIMIT TË DENJË, SI DHE FUQIZIMI I VAJZAVE, TË REJAVE DHE GRAVE, NË TË GJITHË DIVERSITETIN E TYRE.

Rezultatet e pritshme:

I.a. Veprimet e bashkisë Devoll për të nxitur rritjen e punësimit dhe fuqizimin ekonomik të grave e të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përmirësuara ndjeshëm.

I.b. Masat që synojnë nxitjen e sipërmarrjes së grave dhe të rejave, në të gjithë diversitetin e tyre, të përshtatura me nevojat e tyre specifike.

Objektivat specifikë:

I.1. Rritja e pjesëmarrjes ekonomike dhe sociale të grave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, me fokus gratë dhe vajzat nga zonat rurale, të rinjtë dhe gratë kryefamiljare

I.2. Mbështetja e grave sipërmarrëse dhe atyre të angazhuara në bujqësi, turizëm rural dhe zanate tradicionale

I.3. Përmirësimi i aksesit të grave dhe vajzave në arsimin profesional, teknologji dhe tregun e punës.

Treguesit në nivel objektivi specifik:

I.1.a. Numri i grave dhe të rejave përfituese nga aktivitetet e fuqizimit të kapaciteteve (trajnime dhe programe të formimit profesional), ndarë sipas moshës, përkatësisë etnike-kulturore, aftësisë së kufizuar, vendbanimit, llojit të aftësive të përfituara (llojit të trajnimit)

I.1.b. Numri i sipërmarrjeve të reja, të themeluara ose të drejtuara nga gratë dhe të rejat, të cilat kanë marrë mbështetje financiare nga bashkia dhe/ose burime të tjera financimi (donatorë të huaj) gjatë periudhës së zbatimit të Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ), e ndarë sipas sektorëve (biznes, bujqësi, turizëm, teknologji, etj.).

Fusha e Ndërhyrjes 2: PARANDALIMI DHE TRAJTIMI NGA TË GJITHA FORMAT E DHUNËS NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE.

Rezultatet e pritshme:

II.a. Mekanizmi i Koordinuar i Referimit kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, funksional, i trajnuar dhe efikas.

II.b. Një brez i ri i barazisë, që luftón steriotipet gjinore, praktikat e dëmshme dhe diskriminimin apo disavantazhimin e shumëfishtë, i krijuar dhe fuqizuar.

II.c. Veprimet e bashkisë për ndërtimin e komuniteteve të sigurta, të paqta e gjithëpërfshirëse, të përmirësuara ndjeshëm..

Objektivat specifikë:

II.1. Fuqizimi dhe rritja e efikasitetit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) vendor për parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore.

II.2. Zvogëlimi i steriotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë, përmes edukimit të shoqërisë me parimet e barazisë gjinore.

II.3. Deri në fund të vitit 2028, Qendra Multifunksionale e Bashkisë Devoll do të funksionojë si një njësi e integruar reagimi emergjent, që ofron ndihmë të menjëhershme dhe referim për viktimat e dhunës dhe familjet në nevojë, duke ndikuar drejtpërdrejt në sigurinë, dinjitetin dhe përfshirjen e grave në komunitet.

Treguesit në nivel objektivi specifik:

II.1.a. Numri i rasteve të dhunës në familje të denoncuara dhe të trajtuara nga MKR, krahasuar me numrin total të rasteve të dhunës në familje të regjistruara nga Bashkia.

II.1.b. Përqindja e buxhetit të bashkisë dedikuar shërbimeve mbështetëse të specializuara për rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

II.2.a. Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese të organizuara nga bashkia për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Fusha e Ndërhyrjes 3: FUQIZIMI INSTITUCIONAL I BASHKISË DEVOLL PËR INTEGRIMIN E BARAZISË GJINORE NË POLITIKAT VENDORE DHE SHËRBIMET KOMUNITARE PËR GRATË DHE VAJZAT

Rezultatet e pritshme:

III.a. Përgjegjshmëria dhe transparenca e bashkisë mbi përmbushjen e angazhimeve publike për barazinë gjinore, e rritur ndjeshëm.III.b. Bashkia Devoll ka strukturë funksionale dhe person të dedikuar për çështjet e barazisë gjinore dhe punën me gratë.

III.c. Stafi bashkiak (drejtori, punonjës socialë, specialistë të zhvillimit ekonomik, staf i NJësive Administrative) zotëron aftësi për të aplikuar qasje gjinore në politikat dhe shërbimet vendore.

III.d. Bashkia zhvillon bashkëpunim të qëndrueshëm me OJF-të dhe institucionet lokale për zbatimin e masave të barazisë gjinore.

Objektivat specifikë

III.1. Krijimi dhe funksionimi i pozicionit të dedikuar për barazinë gjinore në Bashki.

III.2. Rritja e kapaciteteve të stafit bashkiak (drejtori, specialistë të shërbimeve sociale, zhvillimit ekonomik dhe njësive administrative) mbi integrimin gjinor dhe punën me grupet vulnerabël, gratë, vajzat, të rinjtë.

III.3. Krijimi dhe funksionimi i pozicionit të dedikuar (Koordinator Lokal Kundër Dhunës në Familje dhe/ose Nëpunës së Barazisë Gjinore) në strukturën e Bashkisë Devoll

III.4. Të zhvillohet një udhëzues praktik për integrimin gjinor në planifikim, buxhetim dhe ofrim shërbimesh.

Treguesit në nivel objektivi specifik:

III.1.a. Pozicioni miratuar dhe buxhetuar në strukturën e Bashkisë, emëruar dhe aktiv që nga viti 2025

III.2.b. Të paktën 20 punonjës të trajnuar në integrim gjinor

III.3.c. Udhëzues i brendshëm për integrimin gjinor i hartuar dhe i miratuar.

Përfundimisht, ky dokument do ti shërbejë të gjithë qytetareve të Bashkisë Devoll që i përkasin kategorive të mësipërme duke nxitur pjesëmarrjen qytetare, aktivizimin e tyre në jeten publike dhe respektimin e të drejtave të tyre duke nxitur zhvillimin e demokracisë dhe respektimin e mëtejshem të të drejtave qytetare.

Përgjegjes i Sektorit të Kujdesit Social dhe PAK
Marilda Bejleri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
KESHILLI I BASHKISE

VENDIM

Nr 67.Datë 30.06. 2026

"PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË BARAZISË GJINORE BASHKIA DEVOLL 2026–2028"

Në mbështetje të nenit 24 dhe 54 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, nenin 36 të Ligjit Nr. 121/2016 "Për shërbimet të kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", I ndyshuar, Ligjit 22/2018 "Për strehimin social", ligjit Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojten e Fëmijëve", Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverjes vendore", i ndryshuar, Ligji Nr.64/2025 "Për barazinë gjinore", Ligji Nr. 11/2026, "Për parandalimin dhe mbrotjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje", Ligji Nr.10221/04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, VKM-së Nr. 224 datë 09.04.2024 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimet të kujdesit shoqëror".

VENDOSI:

1. Te miratoje Planin Vendor të Barazisë Gjinore për Bashkinë Devoll 2026-2028
2. Shfuqezimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr 28. datë 27.02.2026
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore dhe Sektori i Planifikimit të Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar.

Këshilli i Bashkisë Devoll miratoi vendimin me 11 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim

Ky vendim u shpall më 01.07.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
ALFRED GJATA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

Adresa: Bashkia Devoll, Lagja Nr. 1, Rr. 24 Tetori Nr. 9, Tel & Fax +35581123815-22288, e-mail: bashkiadevoll@gmail.com